



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 430/12 prot.

Tiranë, më 12.03.2021

V E N D I M

Nr. 28 datë 12.03 2021

PËR

SHTESA NË VENDIMIN E SENATIT NR. 27 DATË 29.10.2020
“PËR MIRATIMIN E PROPOZIMIT TË TARIFAVE TË SHKOLLIMIT
PËR TË DY CIKLET E STUDIMEVE, NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE
TË TIRANËS” .

Në zbatim të pikës 3 /ç, neni 3, neni 6, pika 30, neni 38, Ligjit nr.80/2015 ”Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në RSH”, në VKM nr. 288 datë 21.05.2018” Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në IPAL, në një program të ciklit të parë të studimeve ose në një program të integruar të studimeve profesionale me kohë të plotë”, të ndryshuar , Senati në mbledhjen e tij të datës 12.03.2021,

V E N D O S I :

1. Të miratojë propozimin për shtesë në Vendimin e Senatit nr. 27 datë 29.10.2020 ”Mbi miratimin e propozimit për tarifën e shkollimit, për vitin 2020-2021” në pikën 2 shtohet 2.1, si më poshtë vijon:

Studenti i cilësuar në bazë të rregullores së UST si përsëritës, që nuk është i detyruar të ndjekë procesin mësimor gjatë vitit akademik, por i ka mbetur pa shlyer vetëm provimi i formimit do t'i nënshtrohet vetëm një tarife shkollimi për kreditet e mbetura, për vitin akademik 2020-2021.

2. Ky vendim i përcillet për miratim Bordit të Administrimit.

KRYETARI I SENATIT

Prof. Dr. Agron Kasa

